LIGJ
Nr. 57/2014

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT EKONOMIK KOMBËTAR[1]
(ndryshuar me ligjin nr.2, datë 25.1.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Krijimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar (KEK), për garantimin e bashkëpunimit institucional dhe të partneritetit publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike, për garantimin e dialogut dhe këshillimit ndërmjet organeve të administratës shtetërore dhe sektorit privat, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen publike dhe përfaqësimin e sektorit privat në këtë proces.

2. Përcaktimin e parimeve dhe procedurave, në bazë të të cilave bazohet dhe zhvillohet procesi i dialogut dhe i këshillimit në KEK.

Neni 2
Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji janë nismat dhe praktikat e organeve të administratës shtetërore për ndryshimin e ligjeve apo akteve nënligjore, si dhe projektet për ndryshimin e politikave, të cilat kanë ndikim në fushat e ekonomisë, konkretisht:

a) strategjitë dhe programet qeveritare të zhvillimit të ekonomisë;
b) përgatitja e Buxhetit të Shtetit dhe paketave fiskale;
c) politikat e privatizimit dhe prokurimeve publike;
ç) politikat e nxitjes së investimeve;
d) politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;
dh) politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve;
e) politikat e punësimit dhe të pagave;
ë) politikat e edukimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor;
f) monitorimi i ndikimit në klimën e biznesit i praktikave rënduese burokratike dhe rastet e arbitraritetit të administratës shtetërore;
g) përmirësimi i legjislacionit tatimor dhe procedurave përkatëse;
gj) çështje të tjera me ndikim në zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Shqipërisë.

2. Me nisma të organeve të administratës shtetërore nënkuptohen të gjitha projektet për ndryshimin e ligjeve apo akteve nënligjore, si dhe projektet për ndryshimin e politikave me ndikim në fushat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 3
Parimet në të cilat mbështetet procesi i këshillimit publik

1. Procesi i këshillimit publik në KEK bazohet në:

a) parimin e publikimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të grupeve të interesit të propozimeve e

[1] Ligji nr.57, datë 5.6.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, datë 2 korrik 2014.
Ligji nr.2, datë 29.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 12 shkurt 2018.

projektakteve dhe/ose politikave që propozohen nga administrata shtetërore;

b) parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve e sugjerimeve me biznesin, mbi të cilin kanë ndikim nismat legjislative dhe/ose politikat e reja të propozuara nga administrata shtetërore;

c) parimin e angazhimit të grupeve të interesit, nëpërmjet përfshirjes së grupeve të ndryshme të interesit në procesin e identifikimit dhe formulimit të çështjeve, politikave dhe zgjidhjeve, objekt i rregullimit.

2. Dialogu në KEK zhvillohet nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, vërejtjeve, sugjerimeve e propozimeve përmes faqes zyrtare të internetit të këtij këshilli, mbledhjes periodike të përfaqësimit të lartë dhe takimeve e formave të tjera të organizimit në funksion të realizimit të qëllimeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 4

Publikimi i nismave ligjore

1. Ministria përgjegjëse përzgjedh nga nismat e organeve të administratës shtetërore ato nisma që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, siç përcaktohet në nenin 2, të cilat ia paraqet, sipas parashikimit të pikës 2, të këtij neni, sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, i krijuar në përputhje me përcaktimin e nenit 9 të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse merr në dorëzim nga organet e administratës shtetërore dhe vë në dispozicion të sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, pa pagesë, sa më poshtë:

a) informacion në lidhje me qëllimin e nismës ku shpjegohet se:

i) çfarë synohet të rregullohet, të ndryshohet dhe/ose të përmirësohet;

ii) cili është ndikimi në sektorin privat;

iii) cili është ndikimi financiar i parashikuar;

iv) informacione të tjera që janë të nevojshme për të shpjeguar nismën në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;

b) tekstin e ligjit dhe/ose aktit nënligjor që propozohet;

c) kur është rasti, tekstin e ligjit dhe/ose aktit nënligjor ekzistues ku janë integruar ndryshimet e propozuara;

ç) tekstin e politikës që propozohet;

d) kur është rasti, tekstin e politikës ekzistuese ku janë integruar ndryshimet e propozuara.

3. Sekretariati teknik publikon në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar informacionin e marrë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 5

Faqja zyrtare e internetit dhe marrja e mendimit

1. Grupet e interesit, të cilat ndikohen nga nismat legjislative të organeve shtetërore, mund të paraqesin vërejtjet, komentet a sugjerimet drejtpërsëdrejti në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar. Gjithashtu, grupet e interesit mund të kërkojnë nga sekretariati teknik i këtij Këshilli që të publikojë në faqen e vet zyrtare të internetit edhe ato nisma të organeve të administratës shtetërore, të cilat nuk janë përzgjedhur nga *ministria përgjegjëse*, sipas nenit 4, të këtij ligji, por që grupet e interesit i konsiderojnë të përfshira në fushën e zbatimit të këtij ligji, siç përcaktohet në nenin 2 të këtij ligji.

2. Afati, brenda të cilit grupet e interesit duhet të paraqesin vërejtjet, komentet e sugjerimet e tyre, është 60 ditë kalendarike nga e nesërmja e publikimit të projektaktit të parashikuar në nenin 4 të këtij ligji. Po kështu, për 60 ditë kalendarike nga e nesërmja e publikimit, organet shtetërore angazhohen të mos i japin fuqi ligjore projektaktit të përgatitur prej tyre.

3. Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar grumbullon vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e përmendura në këtë nen, të cilat i përpunon e ia transmeton organit shtetëror që ka marrë nismën për përgatitjen e aktit.

4. Përjashtimisht, në rastet e nevojës për përshpejtimin e procesit të miratimit të projektakteve, sekretariati teknik, me propozimin e *ministrit përgjegjës*, vendos që të mos kryhet procesi i konsultimit, sipas këtij neni, ose që afatet e sipërpërmendura të shkurtohen. Në çdo rast, në momentin e publikimit të projektakteve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, sekretariati teknik publikon edhe afatin për dhënien e komenteve.

5. Kushtet dhe rregullat për përcaktimin e subjekteve, të cilave do t'u jepet akses në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar për të publikuar aty sugjerimet dhe komentet e tyre, përcaktohen nga sekretariati teknik.

Neni 6

Angazhimi i grupeve të interesit

1. Grupet e interesit, përveç sa përcaktohet më sipër në këtë ligj, mund të parashtrojnë në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar propozimet e tyre për legjislacion të ri apo për takime e forma të tjera organizimi, sipas nenit 8 të këtij ligji.

2. Në rastet kur grupet e interesit propozojnë ndryshime në ligjet, aktet nënligjore dhe/ose politikat ekzistuese apo aktet nënligjore dhe/ose politikat e reja, propozimet e tyre duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a" - "d", të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji.

3. Grupet e interesit mund të denoncojnë nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar çdo praktikë burokratike të tepërt, veprim arbitrar, moszbatim të ligjit apo abuzim me ligjin dhe autoritetin shtetëror nga ana e administratës shtetërore ndaj subjekteve private.

4. Grupet e interesit, që kanë të drejtën e veprimeve në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, sipas këtij neni dhe nenit 5, të këtij ligji, konsiderohen vetëm organizatat e biznesit të krijuara, të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin.

Neni 7

Përbërja dhe takimi periodik i nivelit të lartë

1. KEK organizon takime periodike duke u mbledhur çdo muaj në ambientet e ndërtesës së Kryeministrisë të Republikës së Shqipërisë. Takimet drejtohen nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, i cili është Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar. Ministri përgjegjës është zëvendëskryetar dhe kryen detyra në zbatim të këtij ligji dhe ato të deleguara nga Kryetari i Këshillit.

2. Në këto takime marrin pjesë:

a) Kryeministri;

b) ministri përgjegjës;

c) ministri përgjegjës për financën;

ç) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;

d) jo më shumë se 6 personalitete të ekonomisë kombëtare dhe botërore;

dh) jo më shumë se 6 nga tatimpaguesit më të mëdhenj të biznesit privat, vendas ose të huaj, të përfaqësuar nga përfaqësuesit e tyre ligjorë;

e) jo më shumë se 4 organizata biznesi, të krijuara, të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin, të përfaqësuara nga përfaqësuesit e tyre ligjorë;

ë) Sekretari i Përgjithshëm.

3. Përveç subjekteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në këto takime marrin pjesë si të ftuar të përhershëm edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në Fondin Monetar Ndërkombëtar *(International Monetary Fund – FMN*), Korporatën Financiare Ndërkombëtare (*International Financial Corporation – IFC)*, Bankën Botërore *(World Bank – WB)*, Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim *(European Bank for Reconstruction and Development – EBRD)*, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve e Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

4. Me miratimin e Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, ftohen të marrin pjesë në këto takime, rast pas rasti, edhe personat e mëposhtëm:

a) ministri i linjës ose përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore që mbulojnë fushën, problematika e së cilës diskutohet në një mbledhje të caktuar;

b) akademikë, vendas dhe/ose të huaj, të shquar në fushën e ekonomisë, apo personalitete të tjera;

c) përfaqësues të organizatave të tjera të biznesit;

ç) subjekte të tjera.

5. Subjektet e përcaktuara në shkronjat "dh" dhe "e", të pikës 2, të këtij neni, përzgjidhen nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar ndërmjet atyre subjekteve që aplikojnë pranë sekretariatit teknik për të marrë pjesë në takimet periodike. Këto subjekte marrin pjesë në takime për një periudhë gjashtëmujore nga dita e pranimit të pjesëmarrjes së tyre dhe me kalimin e kësaj periudhe ata zëvendësohen nga subjekte të tjera, që i përkasin së njëjtës kategori.

6. Subjektet e përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij neni, përcaktohen nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe kanë të drejtë të marrin pjesë në këto takime për një periudhë që do të përcaktohet,

sipas rastit, në varësi të mundësisë së tyre.

7. Pjesëmarrja në këto takime e subjekteve të përmendura në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, mund të ndalohet nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar, nëse ata shkelin detyrimin për të mbajtur konfidencial dhe për të mos përhapur në media, në shtypin e shkruar apo në çdo formë a forum tjetër informacionet që marrin për shkak të pjesëmarrjes së tyre në këto takime. Zëvendësimi i tyre bëhet nga subjektet e tjera në listën e aplikuesve për të marrë pjesë në këto takime.

8. Pjesëmarrja në takimet periodike është pa shpërblim. Subjektet e përmendura në shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 2, të këtij neni, mund të heqin dorë në çdo kohë nga pjesëmarrja në këto takime.

9. Mënyra e organizimit të mbledhjeve përcaktohet sipas rregullores për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, të miratuar nga KEK.

10. Rendi i ditës i takimeve periodike përgatitet nga sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe miratohet nga zëvendëskryetari, pas këshillimit me Kryetarin e Këshillit.

11. Sekretariati teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar u bën të ditur pjesëmarrësve në takim, të paktën 7 ditë kalendarike përpara, kohën kur do të zhvillohet takimi, çështjet për diskutim në rend dite, si dhe u vë në dispozicion materialet e takimit.

Neni 8

Forma të tjera këshillimi të Këshillit Ekonomik Kombëtar

1. Me akt nënligjor të Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe me propozim të *ministrit përgjegjës* apo të Sekretarit të Përgjithshëm mund të krijohen komisione këshillimi, si struktura ad hoc të këshillit për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë. Komisionet e këshillimit janë të përkohshme dhe përfundojnë funksionimin e tyre me mbarimin e detyrave që u janë ngarkuar. Ato drejtohen nga *ministri përgjegjës*. Komisionet e këshillimit kryejnë detyrat e përcaktuara në aktin e krijimit të tyre. Me propozimin e tyre dhe me vendim të Këshillit Ekonomik Kombëtar, ato mund të ngrenë sekretariate të këshillimit sektorial.

2. Këshilli Ekonomik Kombëtar mund të organizojë, nëpërmjet sekretariatit teknik të tij, takime midis grupeve të interesit dhe organeve e institucioneve të ndryshme të administratës shtetërore, që do të ndërmerren me kërkesë të grupeve të interesit apo organeve shtetërore.

3. Këshilli Ekonomik Kombëtar mund të organizojë edhe forma të tjera këshillimi, të cilat mund të jenë të përshtatshme sipas rastit.

Neni 9

Sekretariati teknik

(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1, shtuar në fjalinë e parë të pikës 4, ndryshuar fjalia e parë e pikës 5 dhe shfuqizuar pika 6 me ligjin nr.2/2018, datë 25.1.2018)

1. Pranë Këshillit Ekonomik Kombëtar funksionon sekretariati teknik që kryen funksione ndihmëse dhe administrative, me seli pranë ambienteve të ndërtesës së Kryeministrisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të sekretariatit teknik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Sekretariati teknik kryen funksionet e mëposhtme:

a) administron faqen zyrtare të internetit të Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe përcakton rregullat e aksesit në këtë faqe;

b) grumbullon dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet, denoncimet dhe propozimet e grupeve të interesit në procesin e këshillimit publik, të zhvilluar sipas këtij ligji;

c) u dërgon ministrive përkatëse, Këshillit Ekonomik Kombëtar dhe/ose institucioneve të tjera shtetërore informacionin e përpunuar dhe dokumentacionin shoqërues, kur është rasti;

ç) monitoron dhe zbaton projektet dhe nismat e Këshillit Ekonomik Kombëtar;

d) ndihmon dhe mbështet Këshillin Ekonomik Kombëtar në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve;

dh) me kërkesë të Kryetarit të Këshillit Ekonomik Kombëtar, kryen anketime, përgatit raporte dhe studime për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së këshillit;

e) analizon fenomenet e praktikave arbitrare apo shqetësime të tjera të identifikuara nga organizatat e biznesit dhe jep rekomandimet përkatëse;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar.

3. Sekretariati teknik drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ekonomik Kombëtar, i cili e kryen këtë funksion pa shpërblim. Sekretari i Përgjithshëm përfaqëson sekretariatin teknik në marrëdhënie me të tretët.

4. Kryetari i Këshillit Ekonomik Kombëtar, me propozim të ministrit përgjegjës, emëron Sekretarin e Përgjithshëm nga radhët e biznesit me eksperiencë në fushën ligjore dhe/ose ekonomike, për një afat katërvjeçar, me të drejtë riemërimi. Sekretari i Përgjithshëm nuk është funksionar publik dhe nuk gëzon statusin e nëpunësit civil. Sekretari i Përgjithshëm drejton dhe mbikëqyr punën e sekretariatit teknik si monitorues dhe mediator i dialogut shtet-privat dhe kryen detyrat e tjera të ngarkuara nga ky ligj.

5. Struktura organizative e sekretariatit teknik miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës. Marrëdhëniet e punës së personelit të sekretariatit teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe punonjësit e këtij sekretariati nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

6. Shfuqizuar.

7. Sekretariati teknik mund të vendosë që të rimbursojë shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen dhe angazhimin, pranë Këshillit Ekonomik Kombëtar, të subjekteve të përmendura në nenin 7, pika 2, shkronja "ç", dhe pika 4, shkronja "b", të këtij ligji.

Neni 9/1

Institucioni përgjegjës

(shtuar me ligjin nr.2/2018, datë 25.1.2018)

Institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Dispozita të fundit

Ligji nr. 9607, datë 11.9.2006, "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit", shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8614, datë 30.6.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani